



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 04
Prishtinë, më 22 shkurt 2012, në orën 10:00 sala N-225
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Adem Grabovci

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatore, KIPRED (staf mbështetës) – Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 30.01.2012 dhe 01.02.2012,
3. Shqyrtimi i propozimplanit vjetor financiar për aktivitetet e Komisionit dhe azhurnimi i listës ekzistuese të ekspertëve për vitin 2012,
4. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 30.01.2012 dhe 01.02.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 30.01.2012 dhe 01.02.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimit planit vjetor financiar për aktivitetet e Komisionit dhe azhurnimi i listës ekzistuese të ekspertëve për vitin 2012,

Kryetari – Sipas Udhëzimit për Administrimin e Buxhetit, Komisioni pas miratimit të planit vjetor të punës, harton edhe planin financiar për aktivitetet e Komisionit dhe azhurnon listën ekzistuese të ekspertëve për aktivitete të Komisionit për vitin 2012. Komisioni ka një listë të ekspertëve të cilën mund ta azhurnoj me emra të rijë. NDI ka shprehur gatishmëri për përkrahje të Komisionit për angazhimin e tre ekspertëve me bashkëfinancim. Po ashtu edhe OSCE ka shprehur gatishmëri për përkrahje Komisionit për aktivitetet brenda Kosovës. Propozoi që në listë të ekspertëve të përfshihet edhe Bashkim Zeqiri dhe Safet Merovci.

Valbona Dibra- Propozoi që në listë të ekspertëve të përfshihet edhe Hysen Ismaili.

Mursel Haljilji - Grupi punues i Komisionit në bashkëpunim me Koordinatorin e Komisionit dhe në konsultim me kryetarin e Komisionit, duke iu referuar listës zyrtare të ekspertëve, identifikon tre (3) deri pesë (5) eksperte të fushës dhe ia paraqet Komisionit për përzgjedhje. Komisioni vendos për përzgjedhjen e dy kandidatëve potencial. Komisioni ka një listë prej 9 ekspertëve. Si do të zgjidhet kjo?

Armend Zemaj – Komisioni mund të ketë një listë prej 30 vetash, por me Udhëzim është kufizuar numri i angazhimit të tyre me mjetet të Komisionit. Komisionin kanë shprehur gatishmëri ta përkrahin NDI dhe OSCE dhe si rezultat i kësaj nuk do të ketë pengesa në angazhimin e ekspertëve.

Bali Muharremaj – Propozoi që lista e ekspertëve të përbëhet nga pesë ekspertë. Është e panevojshme të jetë një listë me e madhe se pesë.

Ramiz Lladrovci - Lista mund të përmbajë numër të madh emrash, kjo nuk përbënë problem. me Udhëzim parashihet se për çështje të caktuara Komisioni mund të angazhojë ekspertë shtesë për atë çështje jashtë listës ekzistuese. .

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Vendim

1. Miratohet plani financiar për aktivitetet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për vitin 2012.
2. Azhurnohet Lista aktuale e ekspertëve në pajtim me Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve Parlamentare.
3. Listën e ekspertëve për aktivitetet e Komisionit për vitin 2012, e përbëjnë: Jusuf Kryeziu, Ujkan Bajra, Mentor Ramosaj, Artan Venhari, Albert Krasniqi, Xhevat Meha, Rustem Asllanaj, Mustaf Hasani, Haki Shatri Bashkim Zeqiri, Hysen Ismaili dhe Safet Merovci.
4. Për çështje të caktuara, Komisioni mund të angazhojë ekspert që nuk është përfshirë në listë. Kjo në pajtim me nenin 4 të Udhëzimit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve Parlamentare.

4. Të ndryshme

a). Përzgjedhja e auditorit të jashtëm për auditimin e ZAP-it për vitin 2011

Bali Muharremaj – Njoftoi anëtarët e Komisioni, se Komisioni Vlerësues është takuar për vlerësimin e ofertave. Prej katër ofertuesve vetëm dy ofertues kanë qenë të përgjegjshëm. Si rezultat i kësaj Komisioni ka vendosur që të anulohet tenderi dhe të rishpallet njoftimi për kontratë.

Armend Zemaj – Komisioni vlerësues ka kërkuar që të respektohen kriteret e njoftimit për kontratë dhe ka vendosur që të anulohet tenderi. Tani më kjo çështje është në procedurë të përsheptuar.

b). Diskutim rreth nismës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë, Ligjit nr. 03/L075

Kryetari – Tha se Qeveria në programin legjislativ nuk ka përfshirë plotësim ndryshimin e Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë, Ligjit nr. 03/L-075. Komisioni tani ndodhet para dy situatave: a do ta beje këtë Komisioni apo kjo çështje t'i lihet Qeverisë. Duhet pasur parasysh faktin se ky ligj implikon edhe ndryshimin e ligjeve të tjera.

Valbona Dibra – Komisioni është i informuar se ligji nuk ka nevojë për shumë ndryshime, por ka nevojë edhe për ndryshime të ligjeve të tjera. Ndryshimin e këtij ligji duhet ta bëjë Qeveria pavarësisht se këtë mund ta bëjë Komisioni. Propozoi që Komisioni të insistoi që kjo duhet të bëhet nga Qeveria.

Armend Zemaj – Grupi punues që ka bërë monitorimin e këtij ligji ka konstatuar se ky ligj nuk ka pasur pengesa për zbatim. Pengesë kanë qenë ligjet e tjera që kanë të bëjnë me auditimin e OB-ve e sidomos të ndërmarrjeve publike. Propozoi që Komisioni të diskutoj lidhur me këtë me ministrin e financave, auditorin e përgjithshëm, drejtorin e departamentit të thesarit dhe të tjerë. Kjo për të marrë informacionet që i interesojnë Komisionit. Ky ligj edhe ashtu do të jetë në plotësim ndryshim, sepse i përket fushës së pavarësisë së mbikëqyrur. Edhe nëse Komisioni ndërmerr nismë sipas rregullores duhet ta dërgoj në Qeveri për mendim. Dhe nëse ndiqet kjo rrugë kjo, çështje do të stërzgjetet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

1. Për të diskutuar rreth nismës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë, Ligjit nr. 03/L-075, në mbledhjen e radhës, Komisioni do të ftojë mbledhje: Ministrin e Ministrisë së Financave(ministri duhet të ftoj edhe drejtorin e Departamentit të Thesarit), Auditorin e Përgjithshëm, përfaqësues nga KDI.
2. Mbledhja e radhës mbahet ditën e mërkurë, datë 07 mars 2012, ora 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu